



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5350 prot.

Himarë, më 22.07 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k dhe “Gant Contruction” sh.p.k., për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË


Himarë

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, VKM nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31/10/2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28/04/2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k dhe “Gant Contruction” sh.p.k., për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen

në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi”.

- Relacion mbi projekt vendimin “Për miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k dhe “Gant Contruction” sh.p.k., për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi”.
- Modelin e Akt Marrëveshjes së Shërbimit “Për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”.
- Kopje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31/10/2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës”.
- Kopje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28/04/2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”.

KRYETARI

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5350/prot.
4

Himarë, më 22.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 49, Datë 22.07.2026

PËR

“MIRATIMIN E AKT MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË HIMARË DHE SHOQËRIVE “BREMA AMBIENTE” SH.P.K DHE “GANT CONTRUCTION” SH.P.K , PËR TRANSPORTIN, PRANIMIN, DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN PËRFUNDIMTAR TË MBETJEVE TË GJENEROHEN NË VENDET E DEPOZITIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA TË BASHKISË HIMARË”

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar , ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, VKM nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31/10/2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28/04/2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”, si dhe referuar relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike, Bashkia Himarë me propozim të Kryetarit të Bashkisë me qëllim realizimin e transportit, pranimit, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve që gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

1. Miratimin e akt marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k dhe “Gant Contruction” sh.p.k., për transportin, pranimin,

depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për nënshkrimin e “Akt Marrëveshjes për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Himarë dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI
Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5350/1 prot.

Himarë, më 22.07 . 2026

RELACION:

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E AKT MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË HIMARË DHE SHOQËRIVE “BREMA
AMBIENTE” SH.P.K. DHE “GANT CONSTRUCTION” SH.P.K., PËR
TRANSPORTIN, PRANIMIN, DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN PËRFUNDIMTAR
TË MBETJEVE QË GJENEROHEN NË VENDET E DEPOZITIMIT TË MBETJEVE
TË NGURTA TË BASHKISË HIMARË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projektvendimi që paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Himarë ka për objekt miratimin e Akt-Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k. dhe “Gant Construction” sh.p.k., me qëllim organizimin dhe realizimin e transportit, pranimin, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve që gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë.

Ky projektvendim paraqitet në vijim të zbatimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31.10.2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemit të mbetjeve të ngurta në zonën e Vishës”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28.04.2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemit të mbetjeve të ngurta në zonën e Palasës”, në të cilat Këshilli Bashkiak ka miratuar vendet e depozitimit të mbetjeve dhe njëkohësisht ka ngarkuar Kryetarin e Bashkisë dhe administratën për ndërmarrjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore të nevojshme për administrimin dhe funksionimin e tyre.

Në zbatim të këtyre vendimeve, administrata e Bashkisë Himarë ka hartuar Akt-Marrëveshjen e Bashkëpunimit me shoqëritë “Brema Ambiente” sh.p.k. dhe “Gant Construction” sh.p.k., e cila përcakton mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet palëve për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve në vendet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Vlet të përmendet fakti se këto shoqëri nga kërkimet tona kanë të gjithë logjistikën e nevojshme për realizimin e kësaj sipërmarrje.

Duke qenë se kjo marrëveshje krijon të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet Bashkisë Himarë dhe subjekteve private, si dhe lidhet drejtpërdrejt me administrimin e një shërbimi publik në interes të komunitetit, ajo kërkon miratimin paraprak të Këshillit Bashkiak,

në përputhje me kompetencat që ky organ ushtron sipas legjislacionit për vetëqeverisjen vendore.

I. Baza Ligjore

Ky relacion paraqitet për shqyrtim dhe miratim në mbështetje të:

- Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar;
- Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;
- Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar;
- Ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar;
- Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31.10.2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta në zonën e Vishës”;
- Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28.04.2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta në zonën e Palasës”;
- Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Himarë.

II. Qëllimi i projektvendimit

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e Akt-Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente” sh.p.k. dhe “Gant Construction” sh.p.k., në funksion të zbatimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak për administrimin e vendeve të depozitimit të mbetjeve të ngurta.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet:

- garantimi i transportit, pranimi, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- përcaktimi i detyrimeve dhe përgjegjësi të secilës palë;
- garantimi i administrimit të rregullt të vendeve të depozitimit të miratuara nga Këshilli Bashkiak;
- mbrojtja e shëndetit publik dhe e mjedisit;
- sigurimi i vijueshmërisë së shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve.
- Vijimi i procedurave për pajisjen me V.N.M të vendeve të depozitimit të mbetjeve të ngurta.

Miratimi i kësaj marrëveshjeje përbën vijimin logjik dhe juridik të zbatimit të dy vendimeve të sipërcituara të Këshillit Bashkiak, të cilat kanë përcaktuar vendet e depozitimit dhe kanë ngarkuar Kryetarin e Bashkisë dhe administratën për realizimin e procedurave të nevojshme për funksionimin e tyre.

III. Vlerësimi i projektvendimit

Nga shqyrtimi i projekt-aktit rezulton se:

- marrëveshja është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- objekti i saj lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e vendimeve nr.55, datë 31.10.2025 dhe nr.16, datë 28.04.2026 të Këshillit Bashkiak Himarë;
- marrëveshja rregullon marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe operatorëve ekonomikë për realizimin e një shërbimi publik;
- përcakton qartë përgjegjësitë e secilës palë gjatë transportit, pranimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- krijon bazën juridike për administrimin e ligjshëm dhe të kontrolluar të vendeve të depozitimit të mbetjeve.

Në këto kushte, edhe pse Kryetari i Bashkisë dhe administrata janë ngarkuar nga Këshilli Bashkiak për ndjekjen e procedurave të nevojshme, lidhja e një akt-marrëveshjeje bashkëpunimi me subjekte private kërkon miratimin e Këshillit Bashkiak, si organi kompetent për administrimin e interesit publik dhe të pasurisë publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

IV. Përfundime dhe propozim

Sa më sipër, propozojmë që Këshilli Bashkiak Himarë të marrë në shqyrtim dhe të miratojë Akt-Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema Ambiente”sh.p.k. dhe “Gant Construction”sh.p.k., për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve që gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë.

Miratimi i këtij projektvendimi konsiderohet i domosdoshëm, pasi siguron zbatimin e plotë të Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.55, datë 31.10.2025 dhe nr.16, datë 28.04.2026, garanton funksionimin e rregullt të vendeve të depozitimit të mbetjeve, përcakton marrëdhëniet juridike ndërmjet Bashkisë dhe operatorëve ekonomikë, si dhe garanton administrimin e mbetjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mbrojtjen e interesit publik.

Për këto arsye, propozohet miratimi i projektvendimit dhe autorizimi i Kryetarit të Bashkisë Himarë për nënshkrimin e Akt-Marrëveshjes së Bashkëpunimit, në zbatim të vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe të dispozitave ligjore në fuqi.

DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORI

Ardit Muhëmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. _____ Prot

Datë _____.____.2026

AKT MARRËVESHJE SHËRBIMI
“PËR TRANSPORTIN, PRANIMIN, DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN
PËRFUNDIMTAR TË MBETJEVE TË GJENEROHEN NË VENDET E
DEPOZITIMIT TË MBETJEVE TË INERTE TË BASHKISË HIMARË”

Në kuadër të trajtimit detyrimit ligjor për trajtimin e mbetjeve të gjeneruara brenda territorit administrative të Bashkisë Himarë, nënshkruhet kjo Akt Marrëveshje Shërbimi sot më datë ____/07/2026 midis palëve:

1. **Bashkia Himarë**, me adresën: Rr. “25 Marsi”, Nr.2, Spile, Himarë, NIPTI: K56703211V, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, z.Vangjel Tavo, këtu e më poshtë i njohur si Pala Përfutuese e shërbimit, e përfaqësuar nga Z./Znj. _____, mbi bazë të autorizimit nr. _____, këtu e në vijim **“PËRFITUESI I SHËRBIMIT”**
2. **Shoqëria “BREMA AMBIENTE” Sh.p.k.**, shoqëri e regjistruar me NUIS: L22316011G, me adresë të selisë qendrore në adresën Rruga “Haxhi Kika”, Nd.5, H.3, Njësia Administrative nr.5, 1022, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori Z. Altin Rrushi, këtu e në vijim **“PËRPUNUESI I MBETJEVE”**.
3. **Shoqëria “GANT CONTRUCTION” Sh.p.k.**, shoqëri e regjistruar me NUIS: K62805404K, me adresë të selisë qendrore në adresën ZK:3385, Nr. Pasurie 61/1 Vol. 2 fq. 84, Nr. Pasurie 61/2, pranë Parkut Industrial Rrashbull, Durrës, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori znj.Matilda Bregu, këtu e në vijim **“TRANSPORTUESI I MBETJEVE”**.

Për qëllim të kësaj AKT MARRËVESHJEJE, **“Përpunuesi i mbetjeve”** dhe **“Transportuesi i mbetjeve”**, së bashku këtu e në vijim **“OFRUESIT E SHËRBIMIT”**.

DUKE QËNË SE EKZISTOJNË KUSHTET SI MË POSHTË VIJON:

- Bashkia Himarë është autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga ligji Nr. 57/2025 **“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**, për grumbullimin, transportin, dhe trajtimin e mbetjeve bashkiake, ndërkohë që është e detyruar të vetë përcaktojë venddepozitimin e mbetjeve inerte dhe ato të ardhura nga ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për vënjen në dispozicion të këtij procesi edhe të sipërfaqes ku do të vendoset stacioni i transferimit të tyre.
- Referuar pikës 23 të nenit 4 të ligji Nr. 57/2025 **“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**, mbetjet inerte përfshijnë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë

transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte janë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore, ndërkohë që referuar pikës 32, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja janë mbetjet e krijuara nga veprimtaria e ndërtimit dhe e shembjes.

- Trajtuesi i mbetjeve, posedon një Marrëveshjen Koncesioni që daton që në 17.10.2012, me objekt veprimtarie projektimin, ndërtimin, testimin, autorizimin, zhvillimin, operimin e një zone industriale, pjesë e të cilës është edhe trajtimi i mbetjeve, duke përfshirë depozitimin, ndarjen, trajtimin pjesor dhe përfundimtar të tyre, përfshi edhe depozitimin në landfill, referuar legjislacionit në fuqi dhe miratimeve përkatëse leje dhe licensa në këtë sektor dhe është licensuar referuar legjislacionin në fuqi për marrjen në dorëzim dhe përpunimin/asgjesimin e të gjitha kategorive të mbetjeve.
- Transportuesi i mbetjeve është person juridik i licensuar referuar legjislacionin në fuqi për marrjen në dorëzim dhe transportin e të gjitha kategorive të mbetjeve, për ti dorëzuar më pas në strukturat e specializuara dhe të licensuara për trajtimin e mbetjeve. Gjithashtu ky subjekt posedon edhe produktet dhe shërbimin e paketimit të të gjitha kategorive të mbetjeve me qëllim transportin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.
- Në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji, Bashkia Himarë ka kërkuar dhe pranuar ofertën e transportuesit të mbetjeve për tërheqjen e mbetjeve inerte dhe ndërtimore nga stacionet i transferimit Himarë miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31/10/2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të e mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28/04/2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të e mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”, dhe për sjelljen e tyre tek trajtuesi i mbetjeve. Gjithashtu, Bashkia Himarë ka pranuar ofertën e trajtuesit të mbetjeve për pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të këtyre mbetjeve që gjenerohen/grumbullohen pranë stacioneve të transferimit Himarë, të ndodhur në zonën e Vishës dhe Palasës, Himarë.
- Të dy shoqëritë, si transportuesi ashtu edhe trajtuesi janë të specializuara për shërbimet objekt akt marrëveshje dhe posedojnë të gjitha kapacitetet teknike, ligjore dhe burimet e nevojshme infrastrukturore dhe njerëzore për këtë qëllim, ndaj ka pranuar Bashkinë për ofrimin e këtij shërbimi.

BAZA LIGJORE:

Kjo kontratë dhe për pasojë bashkëpunimi midis palëve dhe realizimi i objektit të saj do të bazohet në:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 850 e në vijim;
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
- Ligjin nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”;
- Ligjin nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, te ndryshuar;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.105, datë 09.02.2011 “Për shpalljen “Zone ekonomike me statusin e parkut industrial” të një territori në Rrashbull, Durrës;
- VKM nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- VKM nr.371 datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”;
- VKM nr.641 datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”;
- VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.55, datë 31/10/2025 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të e mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës”;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.16, datë 28/04/2026 “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit të e mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”.

Sa më lart, palët kanë rënë dakord dhe përcaktojnë si më poshtë:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i akt marrëveshjes

1. Objekt i kësaj akt marrëveshje është kryerja e shërbimit të tërheqjes, transportit, pranimi, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve inerte dhe ndërtimore që gjenerohen pranë stacioneve të transferimit të mbetjeve të Vishës dhe Palasës, Bashkia Himarë, nga transportuesi dhe trajtuesi i mbetjeve, në emër dhe për llogari të Bashkisë Himarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e mbetjeve.
2. Qëllimi i kësaj akt marrëveshje është krijimi i marrëdhënies juridiko-civile për kryerjen e shërbimit të tërheqjes, transportit, pranimi, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve industriale të ndodhura brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë, nga transportuesi dhe trajtuesi i mbetjeve, në emër dhe për llogari të Bashkisë Himarë, ose të tretëve në këtë territor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e mbetjeve.
3. Transportuesi i mbetjeve do të pranojë dhe marrë në dorëzim me mjetet e tij mbetjet për trajtimin e tyre në adresën: Parku Industrial Rrashbull, Manskuri, Durrës ZK:2591, nr.pasurie 1, nr. pasurie 2, Shqipëri, dhe më pas trajtuesi i mbetjeve do të realizojë procedurat e pranimi, trajtimin dhe asgjësimit përfundimtar të tyre, kundrejt shpërblimit.
4. Objekt i kësaj akt marrëveshje janë mbetjet bashkiake me kushtin që:
 - a. të përfshihen në licencën dhe autorizimet mjedisore të vlefshme që posedon Shoqëria, të cilat janë pjesë integrale e kësaj akt marrëveshje;
 - b. të përputhen me dokumentacionin shoqëruar në momentin e dorëzimit në adresën e përcaktuar në pikën 1.2 mësipërm;
 - c. të plotësojnë kriteret teknike të pranimi, përfshi dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi.
5. Për eliminimin e çdo lloj paqartësie, lista e kodeve të mbetjeve objekt i kësaj akt marrëveshje, është sipas Aneksit I, bashkëlidhur pjesë përbërëse e kësaj akt marrëveshje.

Neni 2

Afati i akt marrëveshjes

1. Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe afati i saj është 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi me marrëveshje mes palëve.
2. Rinovimi i afatit të Kontratës bëhet pas verifikimit paraprak të:
 - a) vlefshmërisë së licencave aktive të Shoqërisë;
 - b) kapaciteteve teknike të Shoqërisë;
 - c) përmbushjes së detyrimeve sipas akt marrëveshjes nga palët;
 - d) situatës ekonomike dhe mundësisë së financimit nga Bashkia;
 - e) kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Secila nga Palët ka të drejtën e ndërprerjes së kësaj akt marrëveshje në çdo kohë, me njoftim paraprak me shkrim 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara. Në rast të ndërprerjes përpara afatit, Bashkia, detyrohet të likujdojë të plotë faturën e muajit të fundit të shërbimit të lëshuar nga shoqëritë.

Neni 3

Vlera e kontratës

1. Kontraktorët marrin përsipër të kryejnë shërbimet e tërheqjes, transportit, pranimit, depozitimit dhe të trajtimit përfundimtar të mbetjeve, në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore në legjislacionin në fuqi, kundrejt vlerës përcaktuar në Aneksin II bashkëlidhur kësaj akt marrëveshje.
2. Bashkia, merr përsipër se financimi i vlerës së kontratës do të realizohet nga Buxheti i Bashkisë për vitin 2026 i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak *“Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2024 - 2026 të Bashkisë së Himarë”*.
3. Çmimi i përcaktuar në Aneksin II parashikon shërbimin e plotë, nga tërheqja, transporti i mbetjeve nga stacionet e transferimit Vishë dhe Palasë, Bashkia Himarë Himarë, deri në adresën e përcaktuar në pikën 3 të nënit 1 të kësaj akt marrëveshje, dhe ky çmim mbetet pandryshuar për gjatë gjithë kohës së ekzistencës së akt marrëveshjes, me përjashtim të rastit kur palët dakortësojnë me shkrim.
4. Ndryshimi i çmimit referuar Aneksit II, mund të ndodhë për çdo arsye ndërmjet palëve, përfshi edhe rastet e ndryshimit të kostove ose legjislacionit në fuqi, me dakortësi midis palëve.
5. Bashkia do të likujdojë faturën e shërbimit të ofruar nga kontraktorët brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të faturës tatimore elektronike. Fatura do të lëshohet pas kryerjes së rakordimeve mes palëve nëpërmjet emailit me qëllim evidentimin dhe saktësimin e sasive të mbetjeve të pranuara gjatë muajit paraardhës.
6. Pagesat referuar pikës 5 mësipër, do të kryhen nga Bashkia nëpërmjet transfertës bankare, në llogarinë bankare të Shoqërisë. Pas kalimit të afatit 30 ditor, Shoqërisë i lind e drejta e aplikimit të dëmshpërblimit në formën e kamatvonesës në masën 01.% të faturës për çdo ditë vonesë.

Neni 4

Procedura e pranimit, depozitimit dhe trajtimit përfundimtar të mbetjeve

1. Bashkia do të njoftojë më email, të paktën 48 orë përpara nisjes dhe mbërritjes në adresë, për tërheqjen dhe dorëzimin e mbetjeve të cilat do të pranohen, depozitohen dhe do të trajtohen dhe asgjësohen në landfillin e trajtuesit të mbetjeve, në adresën zyrtare: gantconstruction@gmail.com dhe bremaambiente2012@gmail.com.
2. Pas njoftimit sipas pikës 4.1 mësipër, transportuesi i mbetjeve do të kryejë transportin e tyre maksimalisht brenda 48 orëve pas konfirmimit të dhënë elektronikisht nga trajtuesi i mbetjeve, dhe pas arritjes në destinacion, trajtuesi i mbetjeve do të bëjë peshimin e mbetjeve në hyrje të zonës industriale, peshë e cila do të reflektohet në dokumentin e marrjes në dorëzim dhe do të jetë indikator i përlllogaritjes së faturës mujore të shërbimit që do të lëshojnë kontraktorët për Bashkinë.
3. Trajtuesi i mbetjeve, pas pranimit, depozitimit, ndërmerr veprimet e nevojshme për ndarjen/seleksionimin e tyre, dhe pas eliminimit të mbetjeve objekt riciklimi dhe/ose ripërdorimi, do të depozitojë mbetjet në landfillin e pajisur me leje mjedisi tipi A, Nr. leje: PN-0874-12-2021, pjesë e kësaj akt marrëveshje.
4. Të ardhurat e përfuara nga trajtuesi i mbetjeve nga trajtimi, diferencimi i mbetjeve dhe shitja e tyre tek të tretë, do të llogariten në vlerën e kësaj akt marrëveshje sipas akteve të rakordimit midis palëve.

Neni 5

Specifikimi i llojit të mbetjeve

1. Për mbetjet objekt i kësaj akt marrëveshje që do të transportohen dhe do të depozitohen për të bërë përpunimin dhe procesimin përfundimtar të tyre, Bashkia paraprakisht duhet bëjë një kërkesë nëpërmjet e-mailit të dy kontraktorëve, dhe në rast miratimi nga ana e tyre, do të nënshkruhet një amendament i kësaj Akt marrëveshje. Në rast të një kërkesë të tillë, mbetjet duhet të dorëzohen që në momentin e parë tek transportuesi i mbetjeve të diferencuara nga kategoritë e mbetjeve objekt i kësaj akt marrëveshje, konform legjislacionit të zbatueshëm në fuqi dhe rregulloreve për depozitimin e mbetjeve të Shoqërisë.
2. Secila nga palët ofruese të shërbimit, në mënyrë të pavaruar kanë të drejtën që për çdo rast; nëse e shohin të arsyeshme, të kryejnë kontrole të imtësishme apo analiza specifike laboratorike për përcaktimin e tipologjisë së mbetjeve. Në rast se nga këto analiza rezultojnë me përmbajtje mbetjesh me materiale, lëndë apo substanca të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë akt marrëveshje, njoftohen të gjitha palët për ta mbajtur në konsideratë këtë fakt për efekt faturimi dhe depozitimi sipas secilës tipologji të mbetjeve, bazuar në sasinë e depozituar. Në rast se sasia nuk është e përcaktueshme, Bashkia do të detyrohet të paguajë, pa kundështuar vlerën e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Shoqëria sipas diskrecionit të saj ose të tërheqë mbetjet e depozituara.
3. Për qëllim të eliminimit të depozitimit të mbetjeve që nuk janë objekt i kësaj akt marrëveshje, Bashkia Himarë nëpërmjet kësaj akt marrëveshje, merr përsipër që në stacionin e transferimit të mos pranojë, depozitojë ose trajtojë mbetje industriale, mbetje të rrezikshme ose çdo kategori tjetër mbetjesh që nuk përfshihet në autorizimin e stacionit. Çdo subjekt publik ose privat që gjeneron mbetje industriale brenda territorit administrative të Bashkisë Himarë, do të informohet nga Bashkia për detyrimin ligjor që këto mbetje të dorëzohen tek operatorë të licencuar për trajtimin e tyre.

4. Në vijim të masave për realizimin e pikës 2 mësipër, Bashkia angazhohet të mbajë regjistra për rastet e refuzimit të mbetjeve industriale dhe do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente për administrimin e tyre.
5. Në kuadër të kësaj akt marrëveshje, Bashkia vë në dijeni krijuesit e mbetjeve industriale, apo ujrave të ndotur brenda territorit administrativ të saj të pajisen me kontratë përpunimi përfundimtar me asgjësuesin fundor të tyre dhe mos të lejojë depozitimin e tyre në vënde të pamiratuara.

Neni 6

Sasia e mbetjeve që do të transportohen dhe pranohen

1. Sasia totale e mbetjeve duhet specifikuar sipas tipologjisë (llojeve) të cilat Bashkia kërkon të transportojë dhe të depozitojë nëpërmjet një grafiku transporti dhe depozitimi i cili do të jetë pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj Akt marrëveshje pasi palët të dakortësojnë midis tyre. Grafiku i transportimit dhe depozitimeve hartohet nga Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën, për muajin pasardhës.
2. Sasia e mbetjeve që do të transportohen dhe depozitohen do të verifikohet në çastin e mbërritjes tek trajtuesi i mbetjeve dhe do të peshohen në çastin e mbërritjes së mjeteve të transportit nëpërmjet peshores, duke peshuar fillimisht mjetet transportuese me ngarkesë dhe më pas mjetin e shkarkuar, për të llogaritur saktësisht sasinë e depozituar.
3. Nëse procedura e përcaktuar në pikën 2 më sipër nuk do të jetë e mundur për shkaqe teknike, sasia do të llogaritet manualisht, duke pasur njohuri mbi kapacitetin e mjeteve të transportit, ose me një mënyrë tjetër, sikurse Palët do të bien dakord me mirëkuptim.
4. Në momentin e pranimit të ngarkesave të mbetjeve të transportuara dhe të sjella pranë Shoqërisë, do të plotësohen të gjithë formularët standard të procedurës së depozitimit të mbetjeve.

Neni 7

Kushtet dhe mënyra e transportit

1. Transportuesi i mbetjeve, për qëllim të realizimit të kësaj akt marrëveshje, do të vendosë në dispozicion mjetet dhe personelin e vet të trajnuar dhe certifikuar për ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e mbetjeve sipas objektit dhe kushteve të kësaj Akt marrëveshje.
2. Përpara fillimit të procesit të ngarkimit do të kryhet peshimi i automjetit bosh dhe një gjë e tillë do të kryhet edhe pas ngarkimit në momentin që automjeti është gati për të filluar transportimin.
3. Pasi të ngarkohet transportuesi i mbetjeve do të marrë masat për mbulimin e automjetit sipas kushteve dhe kërkesave ligjore për transportin e këtyre mbetjeve.
4. Për realizimin e transportit të mbetjeve Transportuesi i Mbetjeve do të vendosë në dispozicion vetëm mjete që:
 - a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve që do të transportohen;
 - b) janë në përputhje me standardet rrugore;
 - c) plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse të ADR-së;
 - ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

5. Bashkia do të plotësojë dokumentacionin e kërkuar në bazë të legjislacionit të zbatueshëm për transportin e mbetjeve duke plotësuar të dhënat sikurse kërkohet në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore, dhe në atë kopje sikurse kërkohet sipas dokumentave përkatëse të transferimit.
6. Transportuesi i Mbetjeve do të ndjekë dhe zbatojë rregullat e përcaktuara nga trajtuesi i mbetjeve i cili menaxhon vend depozitimin dhe do të kryejë shkarkimin në vendin e përcaktuar nga ky i fundit.
7. Bashkia merr masë për krijimin e kushteve përfshirë, pa kufizim, përkatjen me ujë të mbetjeve e qëllim minimizimin e ndotjes, përpara fillimit të procesit të ngarkimit nga ana e transportuesit të mbetjeve.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

1. Nëpërmjet kësaj akt marrëveshje, Bashkia Himarë ka të drejtë të përfitojë shërbimin objekt i kësaj akt marrëveshje, por në të njëjtën kohë, përveç pagesës për shërbimin e marrë, angazhohet së paku:
 - a) të administrojë stacionin e transferimit të mbetjeve Himarë sipas legjislacionit në fuqi për pranimin dhe depozitimin e tyre;
 - b) të kryejë kontrollin paraprak të mbetjeve, në lidhje me përbërjen e tyre dhe të diferencojë mbetjet që nuk janë objekt i kësaj akt marrëveshje;
 - c) të sigurojë dokumentacionin përkatës për përbërjen e mbetjeve, sasinë dhe transportit të tyre;
 - d) të deklarojë saktë kategorinë dhe sasinë e mbetjeve në dokumentin e transportit dhe në strukturat përkatëse të ngarkuara për këtë qëllim;
 - e) të mos dërgojë në destinacion mbetje që nuk përfshihen në këtë akt marrëveshje.
 - f) Të informojë dhe disiplinojë gjeneruesit e mbetjeve objekt i kësaj akt marrëveshje, përfshi edhe ata që gjenerojnë ujra të ndotur industriale, të kenë kontrata aktive me përpunuesit fundorë të licensuar të tyre;
 - g) Në rast evidentimi të mbetjeve objekt akt marrëveshje të paidentifikuara ose jo në stacionin e transferimit, të kontaktojë dhe kur është rasti ti kontrakttojë Kontraktorët për analizimin e tyre dhe tërheqjen e tyre;
2. Për qëllim të kësaj akt marrëveshje, në vijim të pikës 5.1 mësipër, Bashkia duhet t'i diferencojë mbetjet në burim sipas kodeve "CER", nëse paraqitet nevoja.
3. Bashkia është e detyruar të njoftojë Shoqërinë paraprakisht nëpërmjet emailit zyrtar:
 - a) në rast se do të ketë ndryshim të mjeteve transportuese, duke deklaruar edhe targat dhe të gjitha të dhënat e kërkuara për mjetet zëvendësuese;
 - b) në rast se do të ketë ndryshime që lidhen me transportimin e mbetjeve, shtyrje të afatit ose ndërprerje të shërbimit të ofruar.
4. Bashkia ka detyrimin e respektimit të të gjitha procedurave dhe rregullave të menaxhuesit deri në dorëzimin e tyre pranë transportuesit të mbetjeve.
5. Në rast se nuk respektohen rregullat e përmendura më sipër, secili nga kontraktorët ka të drejtë që pas njoftimit zyrtar të dërguar të refuzojë pranimin e mbetjeve, si dhe të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme dhe të njëanshme këtë akt marrëveshje dhe të ndalojë bashkëpunimin mes Palëve pa asnjë pasojë ekonomiko-juridike.
6. Bashkia do të njoftojë palës ofertuese personin e kontaktit për qëllim të realizimit të kësaj akt marrëveshje, ndërkohë që transportuesi i mbetjeve do të paraqesë dhe do të

vendosë në dispozicion të Bashkisë listën me targat e mjeteve që do të kryejnë transportin e mbetjeve si dhe të dhënat dhe kontaktet e drejtuesve të tyre.

7. Në rast se brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë evidentohen mbetje industriale të depozituara në mënyrë të paligjshme, ndotje industriale të paidentifikuara, përfshi ujra të ndotur industriale, mbetje të rrezikshme, mbetje të braktisura etj, nëse e konsideron të nevojshme, me qëllim trajtimin e tyre referuar legjislacionit në fuqi, Bashkia mund të njoftojë dhe autorizojë kontraktorët, pavarësisht se këto kategori mbetje nuk janë objekt i kësaj akt marrëveshje, për inventarizimin, marrjen e mostrave, analizat laboratorike, klasifikimin e tyre, transportin, trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin e tyre nëse është janë objekt autorizimeve dhe licensave që posedon. Në këtë rast, palët do të dakortësojnë të nënshkruajnë një aneks akt marrëveshje për këtë qëllim ku të përcaktohet objekti i shërbimit, kostot, tarifat dhe afatet përkatëse.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e kontraktorëve

1. Nëpërmjet kësaj akt marrëveshje, palët ofertuese kanë të drejtë të përfitojnë shpërblimin monetar për shërbimin e ofruar, por në të njëjtën kohë, përveç ofrimit të shërbimit angazhohet së paku:
 - a. të pranojë vetëm kategori mbetjesh që përputhen me licencën dhe miratimet që posedojnë;
 - b. të kryejë transportimin dhe trajtimin e mbetjeve referuar kategorisë së tyre dhe sipas legjislacionit në fuqi;
 - c. të mbajë dhe të përditësojë periodikisht regjistrat përkatës të transportit dhe të marrjes në dorëzim dhe të përpunimit të mbetjeve objekt i kësaj akt marrëveshje;
 - d. të lëshojë dokumentacionin për çdo ngarkesë mbetjesh që pranon;
 - dh. të respektojë të gjitha kërkesat mjedisore në fuqi.
2. Në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e mbetjeve objekt i kësaj akt marrëveshje, secili prej ofruesve të shërbimit ka të drejtë:
 - a) të marrë mostra;
 - b) të kryejë analiza laboratorike;
 - c) të refuzojë çdo ngarkesë që nuk përputhet me dokumentacionin ose kriteret teknike.
3. Në rast refuzimi nga ana ofruesve të shërbimit si pasojë e mospërputhshmërisë së llojit të mbetjeve me këtë akt marrëveshje, ngarkesa i kthehet Bashkisë me kostot e saj dhe/ose nëse palët dakortësojnë, transportohet, pranohet, depozitohet dhe trajtohet sipas procedurave ligjore në fuqi dhe kushteve të kësaj akt marrëveshje.
4. Secili nga ofruesit të shërbimit kanë për detyrë të kryejnë në kohë dhe me cilësi shërbimet e përcaktuara në objektin e kësaj akt marrëveshje, për arritjen e qëllimit, ata përdorin të gjitha kapacitetet e saj profesionale.
5. Për realizimin e kësaj akt marrëveshje, secila nga palët përcaktojnë një person kontakti për të gjitha komunikimet, marrjen në dorëzim dhe firmosjen e pranimi të faturave, si dhe shkëmbimin e cdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm.

Neni 10

Njoftimet

1. Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në këtë akt marrëveshje.
2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.
3. Palët kanë detyrimin e njoftimit të ndryshimit të detajeve të adresës dhe kontaktit për kryerjen e njoftimeve sipas kësaj Akt marrëveshje. Detajet e adresës dhe kontaktit të Palëve do të konfirmohen në komunikimin elektronik, si më poshtë vijon:

Për Bashkinë Himarë: info@himara.gov.al

Për transportuesin e mbetjeve: gantconstruction@gmail.com

Për trajtuesin e mbetjeve: bremaambiente@gmail.com

Neni 11

Forca madhore

1. Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Akt marrëveshje nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Akt marrëveshje nëse një mospëmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
2. Për qëllime të këtij neni, “Ngjarja e Forcës Madhore” do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.
3. Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të akt marrëveshjes.
2. Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund ti drejtohet për zgjidhje të mosmarrëveshjes Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 13

Dispozita të përgjithshme dhe të fundit

1. Çdo modifikim i akt marrëveshje i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht akt marrëveshjes dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm.
2. Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas akt marrëveshjes duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

3. Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i akt marrëveshjes është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të akt marrëveshjes.
4. Gjuha e kësaj akt marrëveshje është gjuha shqipe.
5. Akt Marrëveshja do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
6. Kjo akt marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.
7. Kjo akt marrëveshje anulon dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, me shkrim ose verbale, të lidhur ndërmjet palëve mbi lënden/çështjen objekt të marrëveshjes, në lidhje me të cilën palët, reciprokisht e konsiderojnë veten të kënaqur pa patur nevojë të marrin, të japin dhe/apo të kërkojnë.
8. Pavlefshmëria e mundshme e një ose me shume klauzolave të kësaj akt marrëveshje, nuk ndikon në vlefshmërinë e akt marrëveshjes në tërësi. Sidoqoftë, palët marrin përsipër të zëvendësojnë klauzolat e pavlefshme me dakortësi midis tyre, që kanë të njëjtin qëllim.
9. Kjo akt marrëveshje redaktohet në dy (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe, 1 (një) për secilën palë dhe 1 (një) për arsye arkivimi, konform rregullave dhe ligjit.

PALET:

PËRFITUESI I SHËRBIMIT:

BASHKIA HIMARË

KRYETARI

Vangjel Tavo

OFRUESI I SHËRBIMIT:

SHOQËRIA "BREMA AMBIENTE" SH.P.K

ADMINISTRATORI

Altin Rrushi

OFRUESI I SHËRBIMIT:

SHOQËRIA "GANT CONTRUCTION" SH.P.K

ADMINISTRATORI

Matilda Bregu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 828/prot.

Himarë, më 07.11. 2025

VENDIM

Nr. 55. Datë 31/10/2025

PËR

**“MIRATIMIN E VENDIT TË DEPOZITIMIT DHE SISTEMIMIN E
MBETJEVE TË NGURTA, NË ZONËN E VISHËS”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjin nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”, VKM nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, VKM nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM nr.866, datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”, VKM nr.652 datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura”, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” si dhe VKB Himarë Nr.8 datë 20.08.2019 “Mbi miratimin e planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Bashkinë Himarë si dhe miratimin e vënies në dispozicion të hapësirës të stabilizimit dhe kompostimit pranë stacionit të transferimit të mbetjeve në Vumlo”. Nisur nga relacioni i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, pranë Këshillit Bashkiak Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 31.10.2025, miratoi me 7 (shtatë) vota pro, 6 (gjashtë) kundër, 2 (dy) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të “Parkut Logjistik për Depozitimin e Materialeve të Ngurta”, i cili parashikohet të ndërtohet në zonën “Qafa e Vishës”, në territorin administrativ të Bashkisë Himarë” që dalin nga gërmimet e objekteve:

Vendndodhja: Qafa e Vishës, Bashkia Himarë

Sipërfaqja totale: 9 988.64 m²

Funksioni: Depozitim, përpunim dhe menaxhim logjistik i materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte.

2. Të merren të gjitha masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.
3. Ky Vendim është i vlefshëm vetëm për venddepozitimin e përkohshëm të ngurta dhe jo për projekte të tjera ndihmëse.
4. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKTU/Bashkia) dhe akteve ligjore në fuqi.
5. Ky Vendim është i vlefshëm pasi Bashkia të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
6. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
7. Të mbahen parasysh kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Përmiratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
8. Zotëruesit e mbetjeve të ngurta janë të detyruar të depozitojnë mbetjet e ngurta në venddepozitimin e përkohshëm, kundrejt tarifës për ton mbetje të propozuar të miratuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
9. Masa e mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga operacionet e gërmimit, të sistemohen në vendin e caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
10. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
11. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
12. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjekteve.
13. Të bëhet pastrimi i mjetet të punës para daljes nga venddepozitimi për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
14. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë në mjedisin ujor dhe atë tokësor, pranë objektit.
15. Ndalohet rreptësisht ndryshimi i rrjedhës ujore të lumit në afërsi të venddepozitimit.
16. Subjektet të realizojnë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tyre.
17. Subjektet të ndjekin me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
18. Të zbatohetn kushtet teknike për rrethimin e zonës së venddepozitimit, në mënyrë të tillë duke mbrojtur mjedisin ujor dhe atë tokësor nga rrëshkitjet e mbetjeve inerte si dhe nga erozioni.

19. Të vendoset sinjalistika paralajmeruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
20. Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur nje imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
21. Pas përfundimit të depozitimit të mbetjeve të ngurta, të kryhen punime sistemuese dhe rehabilituese që të përfshijnë: Nivelim, rrafshim dhe sistemim të sipërfaqes së vendepozitimit.
22. Në përfundim të punimeve rehabilituese dhe mbylljes së vendepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte, të dorëzohet pranë AKM-së raporti përfundimtar i gjendjes së mjedisit.
23. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Himarë.
24. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3117 prot.

Himarë, më 29.04.2026

VENDIM

Nr. 16, Datë 28.04.2026

PËR

**“MIRATIMIN E VENDIT TË DEPOZITIMIT DHE SISTEMIMIT
MBETJEVE TË NGURTA, NË ZONËN E PALASËS”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjin nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”, VKM nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, VKM nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM nr.866, datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”, VKM nr.652 datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura”, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” si dhe VKB Himarë Nr.8 datë 20.08.2019 “Mbi miratimin e planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Bashkinë Himarë si dhe miratimin e vënies në dispozicion të hapësirës të stabilizimit dhe kompostimit pranë stacionit të transferimit të mbetjeve në Vumlo”. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 28.04.2026, miratoi me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 1 (një) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI

1. Miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimin e mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës, i cili parashikohet të ndërtohet në pasurinë nr.30/261 ZK.2863, në territorin administrativ të Bashkisë Himarë” që dalin nga gërmimet e objekteve:

Vendndodhja: Palasë, Bashkia Himarë

Sipërfaqja totale: 9 988.64 m²

Funksioni: Depozitim, përpunim dhe menaxhim logjistik i materialeve të ngurta dhe mbetjeve inerte.

2. Të merren të gjitha masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.
3. Ky Vendim është i vlefshëm vetëm për venddepozitimin e përkohshëm të ngurta dhe jo për projekte të tjera ndihmëse.
4. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKTU/Bashkia) dhe akteve ligjore në fuqi.
5. Ky Vendim është i vlefshëm pasi Bashkia të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
6. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
7. Të mbahen parasysh kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Përmiratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
8. Zotëruesit e mbetjeve të ngurta janë të detyruar të depozitojnë mbetjet e ngurta në venddepozitimin e përkohshëm, kundrejt tarifës për ton mbetje të propozuar të miratuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
9. Masa e mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga operacionet e gërmimit, të sistemohen në vendin e caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
10. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
11. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
12. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjekteve.
13. Të bëhet pastrimi i mjetet të punës para daljes nga venddepozitimi për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
14. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë në mjedisin ujor dhe atë tokësor, pranë objektit.
15. Ndalohet rreptësisht ndryshimi i rrjedhës ujore të lumit në afërsi të venddepozitimit.
16. Subjektet të realizojnë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tyre.
17. Subjektet të ndjekin me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
18. Të zbatohet kushtet teknike për rrethimin e zonës së venddepozitimit, në mënyrë të

tillë duke mbrojtur mjediset ujor dhe atë tokësor nga rrëshkitjet e mbetjeve inerte si dhe nga erozioni.

19. Të vendoset sinjalistika paralajmeruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
20. Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
21. Pas përfundimit të depozitimit të mbetjeve të ngurta, të kryhen punime sistemuese dhe rehabilituese që të përfshijnë: Nivelim, rrafshim dhe sistemim të sipërfaqes së vendepozitimit.
22. Në përfundim të punimeve rehabilituese dhe mbylljes së vendepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte, të dorëzohet pranë AKM-së raporti përfundimtar i gjendjes së mjedisit.
23. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Himarë.
24. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

